



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER GENTJANA BRATI
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR.7, RRUGA GJERGJ FISHTA,
GODINA NR.9, AP. NR. 1, HYRJA NR.1
TEL: 0682032619

KONTRATË KONCESIONI

Nr. repertori: 2775

Nr. koleksioni: 878

Tirane më 23/09/2022



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbajtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2022053840095752287

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë

REPUBLIKA E SHQIPERISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË

NR. 2775 Rep.

NR. 878 Kol.



A2022053840095752287

KONTRATË
PËR

NDËRTIMIN, SHFRYTËZIMIN DHE ADMINISTRIMIN E CENTRALIT GJENERUES
TË ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE, ME KAPACITET PRODHUES 2
MW DHE VEPRAVE NDIHMËSE, NË POVELÇË, BASHKIA FIER, QARKU FIER,
NGA SHOQËRIA "HYDROPOWER" SH.P.K.

Në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, më datë 23, Muaji Shtator, Viti 2022 (dy mijë e njëzet e dy), para meje noter Genjona Bexho, Anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë Tiranë, me Adresë: Blu "Gjergj Fishta" Tiranë u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, që në vijim do të citohet MIE, përfaqësuar me autorizimin e ministrit Nr. 5925/1 Prot., datë 29.08.2022, nga Z. Ilir Tomorr Bejtja, shtetas shqiptar, lindur në Elbasan, më 17.01.1966, banues në Tiranë, mbajtës i Letërnjoftimit ID me nr. personal G60117004R, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

DHE

Mbajtësit të Miratimit për Ndërtim, Shoqëria "HYDROPOWER" Sh.p.k., e regjistruar si person juridik në QKB me NIPT K51828006W, datë regjistrimi 07.06.2005, me seli në Tiranë, në adresën: Autostrada Tiranë – Durrës, KM. 3, Pas Universitetit Kristal, Rruga "Themistokli Gërmenji", Kashar, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Z. Julian Popllaj, shtetas shqiptar, i lindur në Fier, më 15.11.1984 dhe banues në Tiranë, mbajtës i Letërnjoftimit ID me nr. Personal J41115138A, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

MIE (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim "HYDROPOWER" sh.p.k., në vijim referohen individualisht si "Pala" dhe së bashku si "Palët".

Kontratë "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 MW dhe veprave ndihmëse, në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria "HYDROPOWER" sh.p.k."

Faqe 1

Fq. 1



Hyrje



A2022053840693752287

Duke patur parasysh se:

Qeveria e Republikës së Shqipërisë:

1. I ka dhënë një rol të rëndësishëm prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme për përmirësimin e treguesve teknike dhe ekonomike të rjetit elektrik kombëtar;
2. Konsideron ndërtimin e projekteve nga burime të rinovueshme si një element të rëndësishëm të politikës së zhvillimit të sektorit të energjisë;
3. Vlerëson projektet e vogla si një mënyrë që bën të mundur nxitjen e investimeve me anën e kapitalit privat;
4. Është e angazhuar për krijimin, zhvillimin dhe diversifikimin e tregut të brendshëm të energjisë elektrike brenda vendit;
5. Mirëpret investitorët në ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme;
6. MIE me Miratimin Për Ndërtim Nr. 1886/7 Prot, datë 28.07.2022 "*Për ndërtimin e implantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 MW, dhe veprave ndihmëse, në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria "HYDROPOWER" sh.p.k.*", ka miratuar ndërtimin e implantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, në koordinatat sipas përcaktimit të dhënë në Nenin 3 të kësaj Kontrate.

Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim:

1. Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim, shoqëria "HYDROPOWER" sh.p.k., mbështetur në pikën 2 të nenit 49 të Ligjit nr.43/2015 "*Për sektorin e energjisë elektrike*", si dhe në VKM nr. 822, datë 07.10.2015 "*Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni*" e ndryshuar, është pajisur me Miratimin Për Ndërtim Nr. 1886/7 Prot, datë 28.07.2022, "*Për ndërtimin e implantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 MW, dhe veprave ndihmëse, në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier*", me koordinatat e përcaktuara në Nenin 3 të kësaj Kontrate.
2. Mbajtësi i miratimit për Ndërtim, shoqëria "HYDROPOWER" sh.p.k., e cila është e interesuar të investojë me qëllim realizimin e ndërtimit të Centralit Fotovoltaike me koordinatat e përcaktuara në Nenin 3, ka paraqitur të gjithë dokumentacionin sipas përcaktimeve të Nenit 20, të VKM Nr. 822, datë 07.10.2015 "*Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni*" e ndryshuar.
3. Zotëron kapacitetet e nevojshme tekniko-financiarë, për të realizuar projektin sipas objektit të Kontratës.

Kontratë "*Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 MW dhe veprave ndihmëse, në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria "HYDROPOWER" sh.p.k.*"

Faqe 2



Fq. 1

4. Zotëron aftësitë drejtuese, financiare dhe teknike të kërkuara për kontratë bazuar me kërkesat e VKM. Nr. 822 datë 07.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike që nuk janë objekt koncesioni" e ndryshuar.

Palët lidhin këtë kontratë bazuar në pikën 2 të nenit 49 të Ligjit nr. 43/2015 datë 30.04.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar, në Ligjin nr. 7/2017 datë 02.02.2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", VKM Nr. 822 datë 07.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", e ndryshuar, VKM Nr. 369 datë 26.04.2017 "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era".

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni I Përkufizime dhe interpretime

Kudo që në këtë Kontratë përdoren termat e mëposhtme, ato do të kenë kuptimet përkatëse si vijon:

1. **Kontrata** : Kjo kontratë, anekset dhe çdo dokument tjetër që do të bashkëlidhet me të si pjesë përbërëse dhe e pandarë.
2. **Ligj**: përfshin Kushtetutën, Marrëveshjet Ndërkombëtare të ratifikuara nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë, ligjet, aktet normative me fuqinë e ligjit, vendimet e Këshillit të Ministrave, institucioneve të tjera qendrore, aktet e organeve të pushtetit vendor, dhe çdo akt tjetër normativ apo individual me fuqi juridike, si rregullore, udhëzim, urdhër, licencë, leje, autorizim ose çdo akt tjetër i miratuar dhe i shpallur nga autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë, vendime gjyqësore që kanë karakter unikues, akte zyrtare të lëshuara nga çdo organ qendror dhe/ose vendor.
3. **Ligji "Për sektorin e energjisë elektrike"**: Ligji nr. 43/2015 datë 30.04.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar.
4. **Ligji "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"**: Ligji Nr. 7/2017 datë 02.02.2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme".
5. **VKM 822**: Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 822, datë 07.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni" e ndryshuar.
6. **VKM 369**: Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 369 datë 26.04.2017 "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era".

Kontratë "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 MW dhe veprave ndihmëse, në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria "HYDROPOWER" sh.p.k."

Faqe 3

Fq. 1





A2022053840095752287

7. **Ministria:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
8. **Ministri:** Do të thotë ministri përgjegjës për energjinë.
9. **Miratimi për Ndërtim:** Miratimi Për Ndërtim Nr. 1886/7 Prot, datë 28.07.2022 "Për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 MW, dhe veprave ndihmëse, në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria "HYDROPOWER" sh.p.k."
10. **Mbajtësi i miratimit për Ndërtim:** Shoqëria "HYDROPOWER" sh.p.k., e regjistruar si person juridik në QKB me NIPT K51828006W, datë regjistrimi 07.06.2005, me seli në Tiranë, në adresën: Autostrada Tiranë – Durrës, KM. 3, Pas Universitetit Kristal, Rruga "Themistokli Gërmenji", Kashar, Tiranë, Shqipëri.
11. **Central Fotovoltaik:** Centrali Fotovoltaik me vendndodhje në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier, pozicioni gjeografik tregohet në koordinatat në nenin 3 më poshtë, i përbërë nga tërësia e objekteve që shërbejnë për prodhimin e energjisë elektrike fotovoltaike.
12. **Objekti:** Financimi, projektimi, ndërtimi, pronësia, vënia në punë, operimi, shfrytëzimi, administrimi dhe mirëmbajtja e Centralit Fotovoltaik me qëllim prodhimin dhe shitjen e energjisë elektrike.
13. **Investimi:** Vlera totale në lekë ose Euro që do të shërbejë për ndërtimin dhe pajisjen me makineritë e nevojshme të Centralit Fotovoltaik, si dhe çdo shpenzim tjetër të nevojshëm për mirëmbajtjen e impianteve deri në fillimin e prodhimit të energjisë elektrike.
14. **Punimet:** Tërësia e veprimeve për projektimin inxhinierik, ndërtimin dhe vënien në punë të Centralit Fotovoltaik në përputhje me projektin e zbatimit.
15. **Vënia në punë e Centralit Fotovoltaik:** Fillimi i prodhimit të energjisë elektrike.
16. **Leje dhe Licensa:** Akte administrative, që lëshohen nga autoritetet përkatës publike për të bërë të mundur ushtrimin e veprimtarisë sipas objektit të kësaj kontrate, bazuar në legjislacionin në fuqi.
17. **Operimi:** Të gjitha veprimet e Mbajtësit të Miratimit për Ndërtim, për prodhimin, furnizimin, transmetimin, shpërndarjen dhe shitjen e energjisë elektrike, në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.
18. **Royalty:** Sasia e energjisë elektrike, (por jo më të vogël se 2% të sasisë vjetore të prodhimit ose konvertimin e saj në vlerë), që do të jepet falas, në formë royalty, sipas përcaktimeve të Nenit 14 të kësaj Kontrate.
19. **Llogaritja e afateve:** Kur afati është caktuar me ditë, përjashtohet dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati. Afati që është caktuar në muaj ose në vite mbaron me kalimin e asaj dite numerike të javës së fundit ose të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës numerike që ka filluar afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji. Kur dita e fundit e një afati bie në ditë pushimi, afati mbaron në ditën e punës, që vjen pas asaj të pushimit.
20. **Çmimi i blerjes së energjisë nga FTL sh.a.:** Çmimi i aplikueshëm në momentin e lidhjes së kësaj Kontrate, është çmimi në fuqi i miratuar nga ERE për periudhën rregullatore përkatëse.

Kontratë "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 MW dhe veprave ndihmëse, në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria "HYDROPOWER" sh.p.k."

Faqe 4

Fq. 1





- 21. **Sigurimi i kontratës:** Vlera monetare e ngurtësuar në një loga të përbashkët të përbashkët me ose në një shoqëri sigurimesh, sipas preferencës së Mbajtësit të Miratimit për Ndërtim, me qëllim që të garantojë ministrinë në rastin e shkeljes së kontratës nga shoqëria, sipas nenit 22, shkronja "F" të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", e ndryshuar.
- 22. **Enti Rregullator i Energjisë (ERE):** Është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike.
- 23. **Aneks:** Çdo deklaratë, vërtetim, autorizim, vendim, urdhër ose dokument tjetër i nënshkruar nga palët që i bashkëlidhet kësaj Kontrate dhe/ose çdo leje, licence, kontrate ose dokument tjetër lëshuar nga autoritete shtetërore që shërbejnë në ushtrimin e veprimtarisë sipas objektit të kësaj kontrate, janë pjesë përbërëse dhe e pandarë e saj, tani apo në të ardhmen.
- 24. **Instrument Financiar:** Nënkupton çdo marrëveshje huaje, kredie, marrëveshje siguroese ose çdo instrument tjetër i përdorur nga Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim në lidhje me financimin dhe ndërtimin e Centralit Fotovoltaik, duke përfshirë çdo ndryshim, shtesë, rinovim apo zëvendësim të secilit prej këtyre instrumenteve.
- 25. **Pala Financuese:** Nënkupton institucionet financiare të licencuara si të tilla, që do të ndihmojnë Mbajtësin e Miratimit për Ndërtim në financimin e Centralit Fotovoltaik.
- 26. **Leje Ndërtimi:** Është leja e dhënë nga Enti Shtetëror përkatës për Mbajtësin e Miratimit për Ndërtim, me anë të së cilës, këtij të fundit i njihet me shkrim e drejta përfundimtare për Ndërtimin në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe sipas afateve të përcaktuara në këtë Kontratë.
- 27. **Energjia elektrike:** Është energjia elektrike e prodhuar, që rrjedh apo furnizohet në një qark elektrik gjatë një intervali të dhënë kohor viti dhe duke qenë integral në lidhje me kohën e energjisë së mëtejshme, i matur në njësite orare ose megavat (MWh).
- 28. **Rrjeti:** Është rrjeti shqiptar i energjisë elektrike.
- 29. **Kapaciteti i Prodhuar:** Është kapaciteti total i impiantit, i shprehur në MW, siç parashikohet në këtë kontratë.
- 30. **FTL sh.a.:** Furnizuesi i Tregut të Lirë është i ngarkuari me detyrimin e shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë i cili duhet të nënshkruaj një kontratë për blerjen e energjisë elektrike me Prodhuesit me Përparësi të Energjisë Elektrike, sipas legjislacionit në fuqi.
- 31. **AKBN:** Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.
- 32. **Veprim Shtetëror në Kundërshtim me Kontratën është:**
 - a. Kufizime të importit ose masa me efekt të ngjashëm, veçanërisht në lidhje me makineri dhe materiale të nevojshme për realizimin e projektit, apo mbyllje të porteve apo shërbimeve të transportit apo lundrimit, qoftë të vendosura me ligj qoftë të vendosura nga ndonjë organ shtetëror (të ndryshme nga ato që mund të ekzistojnë ose që zbatohen në Datën Efektive të kësaj Kontrate);

Kontratë "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 MW dhe veprave ndihmëse, në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria "HYDROPOWER" sh.p.k."



- b. Kufizime ose masa me efekt të ngjashëm në lidhje me punën e ndërtimit, të nevojshëm në Shqipëri të cilat kanë ndikim negativ në punën e ndërtimit, të ndryshme nga parashikimet aktuale të ligjit në fuqi.
- c. Çdo mos përmbushje e detyrimeve të parashikuara në këtë Kontratë nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të cilat cenojnë drejtpërsëdrejti interesat e Mbajtësit të Miratimit për Ndërtim;
- d. Zgjidhja pa shkak e kontratës në mënyrë të njëanshme, nga MIE.

33. Përveçse kur përmbajtja parashikon ndryshe, në këtë Kontratë:

- Njëjësi e përfshin shumësin dhe anasjelltas;
- Referimi tek njëra gjini përfshin edhe gjininë tjetër dhe gjininë asnjënjë;
- Çdo frazë që fillon me fjalët “duke përfshirë”, “përfshin”, “në veçanti”, “për shembull”, të tilla si apo të ngjashme, do të kuptohet si ilustruese dhe pa kufizim ndaj përgjithshmërisë së fjalëve të përgjithshme të lidhura;
- Titujt e përdorur për nenet, paragrafët, nënparagrafët, Aneksat dhe tabela e përmbajtjes janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e kësaj Kontrate;
- Referimet në dispozitat dhe Aneksat janë, përveç rastit kur parashikohet ndryshe, referime tek dispozitat dhe anekset e kësaj Kontrate.

Neni 2

Objekti i kontratës dhe miratimit

Në bazë të Ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, dhe në VKM Nr. 822, datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni” e ndryshuar, VKM Nr. 369 datë 26.04.2017 “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, Ministria i jep Shoqërisë “HYDROPOWER” sh.p.k., të drejtën e financimit, projektimit, ndërtimit, pronësisë, vënies në punë, operimit, shfrytëzimit, administrimit dhe mirëmbajtjes të Centralit Fotovoltaik, në koordinatat e përcaktuara në Nenin 3 të kësaj kontrate, me vendndodhje në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier, konform kushteve dhe afateve të kësaj kontrate.

Neni 3

Të dhëna të përgjithshme të Centralit Fotovoltaik

Centrali Fotovoltaik në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier do të realizojë ndërtimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike në zonën me këto koordinata :

Kontratë “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 MW dhe veprave ndihmëse, në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria “HYDROPOWER” sh.p.k.”

Faqe 6

Fq. 1



Koordinatat e Centralit Elektrik Fotovoltaik		
Sistemi koordinativ KRGJSH		
Nr.	X	Y
P1	450981.35	4509210.76
P2	451071.31	4509289.87
P3	451191.59	4509159.37
P4	451090.50	4509075.49



A2022053840095752287

Shoqëria "HYDROPOWER" sh.p.k është pajisur me kontratë qiraje Nr. 6095 Rep., Nr. 4122 Kol., datë 03.12.2021. Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira e pasurisë së paluajtshme e Llojit Arë, e ndodhur në Povelçë, Fier, në ZK 3038, me certifikatë pronësie, Kodi Unik 3038001140, Nr. Pasurie 99/4, reflektuar në kontratë me Nr. Pasurie 20/4, me sipërfaqe totale 35,400 m², Nr. Regjistri të aktit 15027, me qëllim ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike.

Centrali Fotovoltaik ka parametrat teknikë dhe energjetikë si më poshtë:

Centrali Fotovoltaik në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier ka këto të dhëna teknike:

- Kapaciteti i prodhimit (MW) - N = 2 MW.
- Prodhimi vjetor i energjisë elektrike (kWh) - E = 3600 MWh/vit.
- Vlera e parashikuar e investimit – 1,960,000 Euro.

Të dhënat e mësipërme mund të pësojnë ndryshime gjatë përgatitjes së projektit të zbatimit, me miratim nga Ministria, por në çdo rast kapaciteti prodhues nuk mund të kalojë mbi 2 MW.

Neni 4 Kohëzgjatja e kontratës

1. Kjo kontratë lidhet për një afat prej 49 (dyzetënjë) vjetësh nga Data e hyrjes në fuqi të kësaj Kontrate me të drejtë ripërsëritje sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij neni.
2. Shtyrja e kohëzgjatjes së kontratës do të bëhet nëse Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim i paraqet Ministrisë një kërkesë me shkrim për zgjatjen e afatit të Kontratës jo më vonë se 90 ditë nga përfundimi i afatit të përcaktuar në nenin 4.1 më sipër, kërkesë e cila duhet të miratohet nga Ministria.

Kontratë "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 MW dhe veprave ndihmëse, në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria "HYDROPOWER" sh.p.k."

Faqe 7

Fq. 1



KREU II
TE DREJTAT DHE DETYRIMET E MINISTRISË



A3022053840095752287

Neni 5
Monitorimi dhe Mbikëqyrja e Përgjithshme

1. MIE, ka të drejtë që gjatë periudhës së ndërtimit të Centralit Fotovoltaik, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), të monitorojë dhe mbikëqyrë objektin për të verifikuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata në të gjitha fazat e ndërtimit të tij.
2. Njoftimi bëhet minimumi 30 ditë para datës së fillimit të kontrollit. Monitorimi nuk mund të bëhet në mënyrë të njëanshme pa praninë e Mbajtësit të Miratimit për Ndërtim.
3. MIE mund të ushtrojë këtë monitorim dhe mbikëqyrje në çdo kohë në rast se ka informacione të arsyeshme dhe të besueshme në lidhje me mosekzekutimin e detyrimeve të kësaj Kontrate. Rezultatet e monitorimit do t'i bëhen të njohura me shkrim Mbajtësit të Miratimit për Ndërtim.

Neni 6
Detyrimet e Ministrisë

MIE merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

1. Të sigurojë vazhdimësinë e kësaj kontrate pavarësisht ndryshimeve të objektivave të Sektorit Elektroenergjetik Shqiptar.
2. MIE është përgjegjëse kundrejt Mbajtësit të Miratimit për Ndërtim për detyrimet ligjore dhe kontraktore në rast të mospërbushjes së tyre nga ana e saj.
3. Të garantojë Mbajtësin e Miratimit për blerjen e të gjithë prodhimit të energjisë nga impianti fotovoltaik gjatë gjithë kohës së operimit të tij, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.
4. Të garantojë për 15 vjet blerjen e energjisë elektrike, në zbatim të përcaktimeve të Ligjit 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme". Çmimi i aplikueshëm në momentin e lidhjes së kësaj Kontrate, është çmimi në fuqi i miratuar nga ERE për periudhën rregulatore përkatëse.

Kontratë "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 MW dhe veprave ndihmëse, në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria "HYDROPOWER" sh.p.k."

Faqe 8



Fq. 1

KREU III
TE DREJTAT DHE DETYRIMET MBAJTËSIT TE MIRATIMIT



A2022053840995752287

Neni 7
Detyrimet e Mbajtësit të Miratimit për Ndërtim

Mbajtësit i Miratimit për Ndërtim është i detyruar të zbatojë Projektin dhe objektin e Kontratës konform termave dhe kushteve të saj.

1. Të marrë të gjitha lejet dhe licencat e nevojshme për realizimin e kësaj Kontrate në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
2. Të zbatojë preventivin e paraqitur sipas Aneksit 1, bashkëlidhur Kontratës;
3. Të zbatojë grafikun e Punimeve sipas Aneksit 2, bashkëlidhur kontratës.
4. Të marrë masa që çdo investim të bëhet sipas afateve të përcaktuara në grafikun e punimeve, pjesë e kësaj Kontrate sipas projektit përfundimtar të zbatimit;
5. Të zbatojë projektin për ndërtimin e Centralit Fotovoltaik, me fuqi totale të vendosur sipas projektit të zbatimit.
6. Të administrojë projektin për jetëgjatësinë e Centralit Fotovoltaik;
7. Të parandalojë dhe kontrollojë çdo ndotje mjedisore të shkaktuar nga ndonjë punim i tij dhe të kthejë ambientin, me shpenzimet e veta, në situatën e mëparshme sipas detyrimeve të përcaktuara nga Ministria përgjegjëse për mjedisin.
8. Të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet që eventualisht mund t'i shkaktohen ministrisë apo palëve të treta me fajin e tij.
9. Të mbajë të informuar MIE për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në ecurinë e projektit;
10. Të marrë masa për të garantuar respektimin e dispozitave të Kodit të Punës dhe rregulloreve përkatëse të sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të mbrojtjes në punë, të higjienës dhe sigurimit nga zjarri, për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë.
11. Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim duhet të marrë masa për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit në fuqi për ruajtjen e ekosistemit natyror në përputhje me rregullat ligjore në fuqi.
12. Në veprimtarinë e tij të zbatojë legjislacionin shqiptar në fuqi;
13. Në kuadër të zbatimit të punimeve për realizimin e projektit, bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, mbajtësi i miratimit është i detyruar të emërojë një subjekt në rolin e mbikëqyrësit të punimeve. Ai mund të jetë person fizik, juridik, vendas apo i huaj, i pajisur me licencën përkatëse për ushtrimin e kësaj veprimtarie.


Kontratë "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 MW dhe veprave ndihmëse, në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria "HYDROPOWER" sh.p.k."

Page 9

Fq. 1



Neni 8
Vlerësimi i Investimeve



A2022053840095752287

1. Mbi bazën e të dhënave të projektit, investimet që duhet të kryhen nga Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim janë në vlerën totale prej 1,960,000 Euro (një milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë) sipas Aneksit nr. 1 bashkëlidhur.
2. Vlera e investimit mund të ketë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet palëve në çdo kohë gjatë ndërtimit të projektit, dhe ky miratim nuk do të refuzohet në mënyrë të paarsyeshme.

Neni 9
Programi punimeve

Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim merr përsipër të zbatojë programin e mëposhtëm kohor të punimeve:

1. Merr përsipër të fillojë punimet për zbatimin e projektit brenda 90 ditësh nga data e pajisjes me lejen e nevojshme për fillimin e punimeve të ndërtimit.
2. Merr përsipër të vërë në punë Centralin Fotovoltaik, brenda 24 muajve nga data e marrjes së të gjitha lejeve për fillimin e punimeve, siç është parashikuar në grafikun e punimeve të paraqitur në Aneksin 2, bashkëlidhur Kontratës. Afati për pajisjen me lejet e nevojshme në përputhje me rregullat e përcaktuara nga strukturat shtetërore është jo më shumë se 12 muaj nga data e hyrjes në fuqi të Kontratës.
3. Këto afate mund të ndryshohen me marrëveshje midis MIE dhe Mbajtësit të Miratimit për Ndërtim, vetëm një herë dhe shtyrja mund të jetë jo më e gjatë se gjysma e afatit fillestar.

Neni 10
Testimi dhe Çertifikata e pranimit të veprës


1. Në përfundim të punimeve, për të siguruar funksionimin e Centralit Fotovoltaik, duhet të kryhet testimi i veprës. Testimi do të fillojë brenda 45 (dyzetepesë) ditëve nga marrja e njoftimit të bërë nga Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim tek MIE.
2. Ky testim do të kryhet nën kontrollin e një grupi pune, në përbërje të të cilit do të ketë përfaqësues të ministrisë, të AKBN dhe të Mbajtësit të Miratimit për Ndërtim, të cilët do të konkludojnë me një raport përfundimtar për lidhur me përputhshmërinë e ndërtimit të centralit fotovoltaik me kushtet e kësaj kontrate, brenda 45 ditëve nga fillimi i testimit.
3. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në Raportin përfundimtar të testimit dhe pas paraqitjes nga Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim të raportit të plotë të shpenzimeve për ndërtimin e veprës, lëshon Çertifikatën e pranimit të veprës sipas legjislacionit në fuqi.
4. Në rast mospjesëmarrjeje të MIE dhe ose AKBN gjatë testimit, Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim ka të drejtë të kryejë vetë testimin dhe vënien në punë të veprës, duke njoftuar MIE me shkrim, brenda 30 ditëve nga testimi dhe vënia në punë.

Kontratë "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 MW dhe veprave ndihmëse, në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria "HYDROPOWER" sh.p.k."

Faqe 10



Fq. 1

5. Çertifikata e Pranimit të veprës lëshohet sipas Aneksit 3, pa  për Ndërtim i ka paraqitur MIE raportin e plotë mbi Investimin për ndërtimin e veprës.

Neni 11 Zgjidhja e Kontratës

I. Zgjidhja e njëanshme e kontratës nga ministria :

MIE ka të drejtë të zgjidhë kontratën duke vendosur heqjen e miratimit të ndërtimit kur Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim nuk ka plotësuar detyrimet dhe kriteret e përcaktuara në aktin e miratimit në rastet e mëposhtme :

1. Në rast se subjekti nuk ka plotësuar detyrimet dhe kriteret e përcaktuara në aktin e miratimit;
2. Nëse nuk ka zbatuar grafikun e punimeve dhe nëse brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi që ministria përgjegjëse për energjinë i bën Mbajtësit të Miratimit për Ndërtim, ky i fundit nuk justifikon mosrealizimin e detyrimit dhe nuk dokumenton mundësitë e tij për të përfunduar në datën e përcaktuar objektin ose ndonjë fazë të tij;
3. Nëse Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim nuk informon siç kërkohet nga neni 17 i kësaj kontrate dhe nëse brenda një afati prej 15 ditësh, pas njoftimit paraprak nga ministria, Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim përsëri nuk dërgon informacionin e kërkuar;
4. Nëse vërtetohet se deklaratimet e Mbajtësit të Miratimit për Ndërtim nuk janë të vërteta; - kur për mbajtësin e së drejtës së ndërtimit kanë filluar procedurat e falimentimit ose likuidimit, sipas legjislacionit në fuqi;
5. Kur mbajtësi i Miratimit për Ndërtim nuk plotëson detyrimin e përcaktuar në nenin 14 të kësaj kontrate;
6. Në çdo rast heqja e së drejtës së ndërtimit, argumentohet dhe i njoftohet subjektit.
7. Në rast se Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim nuk pajiset me lejet e nevojshme nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, brenda afatit të përcaktuar ose nuk siguron financimin për ndërtimin e impiantit.

II. Zgjidhja e njëanshme e kontratës nga Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim;

Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim, ka të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë duke i drejtuar kërkesë me shkrim MIE në të cilën të arsyetohen shkaqet dhe të jepen justifikimet e arsyeshme për këtë kërkesë.

III. Zgjidhja e kontratës nga secila palë;

Secila nga palët ka të drejtë të zgjidhë kontratën kur:

Kontratë "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 MW dhe veprave ndihmëse, në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria "HYDROPOWER" sh.p.k."

Faqe 11

Fq. 1



1. Me gjithë plotësimin e kriterëve nga ana e Mbajtësit të Kontratës, Mbajtësi i Kontratës për aplikim për leje, licenca, në përputhje me legjislacionin në fuqi, Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim nuk është pajisur me to për arsye ligjore.
2. Kur ka shkelje serioze nga njëra palë dhe kjo shkelje nuk korrigjohet brenda afatit kohor dhe mënyrës së parashikuar në kontratë.

IV. Njoftimi i zgjidhjes së kontratës

Secila nga Palët që kërkon zgjidhjen e kësaj Kontrate në përputhje me këtë nen, do të njoftojë paraprakisht me shkrim Palën tjetër. Njoftimi duhet të përmbajë:

- Detajet e duhura duke nënvizuar shkakun e zgjidhjes;
- Datën e përfundimit të kontratës, në rast të mos korrigjimit të shkeljes brenda 40 ditëve nga data e njoftimit;
- Hollësitë e llogaritjes së pagesave, nëse ka, si rezultat i zgjidhjes së kontratës;
- Çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

V. Zgjidhja e kontratës me konsensus:

Palët kanë të drejtë ta zgjidhin këtë kontratë me pëlqim të dyanshëm. Në këtë rast, Ministria ka të drejtë të kërkojë Sigurimin e Kontratës, dhe Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim të respektojë kushtet mjedisore në kohën kur impianti do të shkatërrohet.

Neni 12 Sigurimi i kontratës

- Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim, para nënshkrimit të kontratës, ka ngurtësuar në një institucion bankar ose shoqëri sigurimesh, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të MIE, një shumë prej 98,000 (nëntëdhjetë e tetë mijë) Euro, që përbën 5 % të vlerës totale të Investimit që është 1,960,000 (një milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë) Euro. Formulari i sigurimit të kontratës është pjesë përbërëse, dhe i bashkëlidhet kësaj kontrate.
- Mbajtësit të Miratimit për Ndërtim i lejohet të çngurtësojë 98% (nëntëdhjetë e tetë) të vlerës së sigurimit të kontratës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e testimit të plotë të veprës sipas nenit 10. Ndërsa pjesën e mbetur prej 2% (dy përqind) të vlerës së sigurimit të Kontratës do të çngurtësohet në përfundim të periudhës së kohëzgjatjes së kontratës.

Kontratë "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 MW dhe veprave ndihmëse, në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria "HYDROPOWER" sh.p.k."

Faqe 12



Fq. 1

Neni 13 Sigurimet



A2022053840095752287

1. Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim duhet të sigurojë punimet e ndërtimit, montimit të objektit dhe më pas objektin e plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, të paktën nga rreziqet e parashikuara në Ligjin Nr. 52/2014 dt.22.05.2014 "*Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit*" gjatë gjithë periudhës së jetëgjatësisë së veprës.

Neni 14 Royalty

1. Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim duhet të japë në formë royalty, falas MIE, 2% (dy përqind) të sasisë vjetore të energjisë elektrike të prodhimit vjetor neto të energjisë elektrike, pa pagesë. Kjo sasi do të jepet dhe llogaritet pranë OSHEE Group sh.a. ose çdo institucion tjetër të ngarkuar për administrimin e Kontratës për Blerjen e Energjisë, në faturën e fundit të Muajit Dhjetor, duke bërë llogaritjet për diferencë.

Neni 15 Krijimi i zonave të sigurisë

1. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme dhe do të sigurojë Mbajtësin e Miratimit për Ndërtim, që organet shtetërore kompetente të krijojnë "zona sigurie" duke ruajtur një rreze sigurie, jo më pak se 100 m rreth parcelës së vendit të projektit.

Neni 16 Kufizimet

1. E drejta për ndërtimin e një burimi gjenerues të energjisë, e dhënë sipas këtyre rregullave, mund të transferohet te një person i tretë, tërësisht ose pjesërisht, vetëm me miratimin e ministrit. Çdo transferim te të tretët, pa miratimin e ministrit, është i pavlefshëm.
2. Transferimi i të drejtës së ndërtimit nuk duhet të prish cilësinë dhe nuk përkeqëson vazhdimësinë e realizimit dhe të përmbushjes së detyrimeve.
3. Në rast transferimi Subjekti ku do të transferohet e drejta e ndërtimit duhet të plotësojë dhe të dorëzojë pranë ministrisë të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në nenin 7, të VKM Nr. 822, datë 07.10.2015 "*Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni*" e ndryshuar.

Kontratë "*Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 MW dhe veprave ndihmëse, në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria "HYDROPOWER" sh.p.k.*"

Faqe 13



Fq. 1

**Neni 17
Raportimi**



1. Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim është i detyruar që çdo 3 (tre) muaj të raportojë me shkrim pranë MIE, për veprimtarinë e tij të ndërtimit të burimit gjenerues të energjisë Centralit Fotovoltaik.

**Neni 18
Legjislacioni i zbatueshëm**

1. Lidhja, zbatimi dhe interpretimi i kësaj Kontrate do të bazohet në legjislacionin shqiptar në fuqi.
2. Nëse pas datës së nënshkrimit të Kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet e kontratës zbatimi i tyre nuk duhet të prekë të drejtat e Mbajtësit të Miratimit për Ndërtim në bazë të kësaj kontrate.

**Neni 19
Forca Madhore**

1. "Forca madhore" nënkupton çdo rrethanë që në mënyrë të arsyeshme dhe objektive është absolutisht tej parashikimit dhe kontrollit, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të palës së cënuar që rezulton ose shkakton pamundësi të plotë ose të pjesshme të palës së cënuar për të përmbushur ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj kontrate (përveç kryerjes së pagesave të parave), por vetëm nëse dhe në masën që:
 - a. kjo rrethanë në mënyrë objektive dhe absolute, nuk mund të parandalohet apo nuk ishte e mundur të parandalohet, shmangej ose mënjanohet nga pala e cënuar;
 - b. pala e cënuar ka marrë të gjitha masat e arsyeshme paraprake, kujdesin e duhur dhe masat e arsyeshme alternative në mënyrë që të shmangte pasojën e këtij rasti në aftësinë e palës së cënuar për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj kontrate dhe për të zbutur pasojat e saj;
 - c. ngjarja nuk është ose nuk ka qenë pasojë e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e shkeljes nga pala e cënuar të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj kontrate, dhe
 - d. pala e cënuar t'i ketë dhënë njoftim në afatin e rënë dakord palës tjetër (pala e pacënuar).
2. Konsiderohen Ngjarje të Forcës Madhore:
 - a. Katastrofat e natyrës, përmytjet, tërmetet, ndotje nukleare, pandemi, kimike biologjike dhe çdo ngjarje e barabartë me to;
 - b. Lufta, lufta civile, konflikte të armatosura, akte terroriste, bllokada, embargo që zgjasin për një kohë jo më të vogël se një muaj;

Kontratë "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 MW dhe veprave ndihmëse, në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria "HYDROPOWER" sh.p.k."

Faqe 14



Fq. 1

3. Në rastet e Forcës Madhore pala e dëmtuar duhet të njoftojë palën tjetër në mënyrë të menjhërditshme, duke i treguar dhe arsytuar shtyrjen e përmbushjes së detyrimeve në mënyrë që të gjejnë një rrugë për të lehtësuar efektet e forcës madhore dhe të vazhdojnë kontratën. Vonesat në përmbushjen e detyrimeve për shkak të ngjarjeve të Forcës Madhore, nuk mund të jenë shkak për kërkesa reciproke për zhdëmtim apo për respektimin e detyrimeve kontraktore. Kufijtë e përmbushjes së detyrimeve, do të përcaktohen nga palët në marrëveshje ndërmjet tyre.

4. Zgjidhja e kontratës për shkak të forcës madhore

Pala e prekur nga forca madhore ka të drejtë të zgjidhë kontratën:

- a. në rast se edhe pas zbatimit të pikës 2 të këtij neni, nuk është arritur një zgjidhje në të mirë të projektit,
- b. kur forca madhore zgjat më tepër se 1 muaj.

5. Pasojat e zgjidhjes së kontratës për shkak të forcës madhore.

Në rastet e zgjidhjes së kontratës për shkak të forcës madhore, palët nuk kanë detyrime ndaj njëra tjetres dhe secila palë do të përballojë kostot e veta.

Zgjidhja e mosmarrëveshje që vijnë si pasojë e forcës madhore do të bëhet në përputhje me nenin 22 të kësaj kontrate.

Neni 20 **Hyrja në fuqi e Kontratës**

Kontrata do të hyjë në fuqi pasi të nënshkruhet nga te dy palët, në përputhje me VKM nr.822, date 07.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni" e ndryshuar.

Neni 21 **Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

1. Çdo kundërshti, mosmarrëveshje apo ankesë midis palëve kontraktuese që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate, do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre duke u bazuar në vullnetin e mirë.
2. Kur me gjithë përpjekjet e palëve nuk arrihet një konsensus i përbashkët, kompetente për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Kontratë, do të jetë Gjykata kompetente për zgjidhjen e konflikteve administrative.
Fillimi apo vazhdimi i procedurave për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Kontratë, nuk do të pezullojë zbatimin e projektit sipas objektit të Kontratës përveç kur objekti i mosmarrëveshjes është zgjidhja e kësaj Kontrate.

Kontratë "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 MW dhe veprave ndihmëse, në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria "HYDROPOWER" sh.p.k."

Faqe 15

Eq. 1



Neni 22 Sanksionet



A2022053840095752287

1. Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj Kontrate, në përfundim të periudhës të parashikuar në nenin 9 të kësaj Kontrate, penalizon mbajtësin e miratimit si më poshtë:
 - i. Për çdo ditë vonesë për fillimin e punimeve penalizohet me 10,000 lekë.
 - ii. Për çdo ditë vonesë të vënies në punë (pas fillimit të punimeve të vërtetuara me aktet zyrtare të fillimit të punimeve) penalizohet me 5,000 lekë.
2. Mosrealizimi i prodhimit të energjisë elektrike sipas kushteve të rëna dakord me këtë Kontratë, penalizon Mbajtësin e Miratimit për Ndërtim si më poshtë:
 - i. Në rast mosrealizimi të prodhimit të energjisë elektrike prej 3600 MWh/vit për faj të Mbajtësit të Miratimit, Mbajtësi i Miratimit penalizohet me 5% të vlerës së prodhimit të pa realizuar për periudhën raportuese, dhe Ministrisë i lind e drejta të kërkojë shlyerjen e këtij detyrimi brenda 60 ditësh nga data e marrjes së njoftimit. Në rast se ky detyrim nuk shlyhet në kohë, ministria ka të drejtë që së bashku me shlyerjen e detyrimit kryesor të kërkojë edhe kamatat ligjore.
3. Aplikimi dhe pagimi i penaliteteve sipas këtij neni nuk e çliron Mbajtësin e Miratimit për Ndërtim nga përmbushja e detyrimeve dhe parashikimeve të kësaj Kontrate.
4. Këto penalitete do të mbahen nga Sigurimi i Kontratës parashikuar në nenin 12 më sipër, duke patur parasysh se nëse vlera e këtij sigurimi nuk është mjaftueshme për shlyerjen e penaliteteve, Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim do t'a plotësojë këtë shumë, rast pas rasti.

Neni 23 Rregullimi i shkeljeve

1. Kur MIE konstaton se gjatë periudhës së jetëgjatësisë së objektit gjenerues të energjisë Parkut Fotovoltaik, Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim ka shkelur, ndonjë prej detyrimeve të përmendura në këtë kontratë, ai menjëherë ia bën të njohura këto shkelje Mbajtësit të Miratimit Përfundimtar duke pritur për një periudhë 40 ditore përgjigjen e tij, me argumentet përkatëse. Palët me marrëveshje të përbashkët, do të përcaktojnë mënyrën dhe afatin brenda të cilit do të rregullohet shkelja.
2. Kjo procedurë nuk e zhvesh Mbajtësin e Miratimit për Ndërtim nga detyrimi për të paguar sanksione të tjera me efekte financiare që rrjedhin nga mospërmbushja e detyrimeve.

Neni 24 Mbarimi i kontratës

1. Kontrata mbaron me përfundimin e afatit sipas parashikimeve të nenit 4 të kësaj Kontrate.

Kontratë "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 MW dhe veprave ndihmëse, në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria "HYDROPOWER" sh.p.k."

Faqe 16



Fq. 1



A3672053840093752281

2. Mbarimi i Kontratës me përfundimin e afatit të saj ose në rast të zgjidhjes së parakohshme, nuk e zhvesh Mbajtësin e Miratimit për Ndërtim nga detyrimi për pagimin e detyrimeve të prapambetura ndaj Ministrisë dhe të tretëve.
3. Në rast se Palët e zgjidhin kontratën në kundërshtim me parashikimet e saj, ata detyrohen të dëmshpërblejnë dëmin e shkaktuar palës tjetër.

Neni 25 Konfidencialiteti

1. Secila nga palët duhet të konsiderojë si konfidenciale të gjitha dokumentat dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, qofshin këto tregtare apo teknike, dhe nuk duhet t'ja bëjë të ditura një pale të tretë, të gjithë apo një pjesë të dokumentit apo informacionit.

Neni 26 Ndryshime

1. Kjo Kontratë mund të pësojë ndryshim, shtesa dhe/ose zëvendësime vetëm me marrëveshje me shkrim të dy palëve.
2. Çdo ndryshim i kësaj Kontrate apo anekseve bashkëlidhur saj, pasi të hyjë në fuqi, do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.

Neni 27 Bashkëpunimi midis Ministrisë dhe Mbajtësit të Miratimit

MIE dhe Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

Çdo komunikim për çdo problem ndërmjet palëve, do të bëhet vetëm me shkrim, në adresat e treguara më poshtë nga palët. Palët janë të detyruara t'i njoftojnë menjëherë njëra-tjetrës çdo ndryshim të secilës prej këtyre të dhënave, brenda një afati 10 (dhjetë) ditor nga data e ndryshimit.

Për çdo ndihmë që do t'i kërkohej Ministrisë nga Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim, ky i fundit detyrohet të paraqesë kërkesën me shkrim për çka kërkon në zbatim të detyrimeve të kësaj Kontrate.

Adresat dhe numrat e kontaktit që do të përdoren gjatë zbatimit të kësaj kontrate janë:

Kontratë "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 MW dhe veprave ndihmëse, në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria "HYDROPOWER" sh.p.k."

Faqe 17



Fq. 1

Për MIE

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", Nr. 1,

Tiranë - Shqipëri

Për Mbajtësin e Miratimit



"HYDROPOWER" sh.p.k.

Adresa: Autostrada Tiranë – Durrës, KM. 3,
Pas Universitetit Kristal, Rruga "Themistokli
Gërmenji", Kashar, Tiranë, Shqipëri.

Neni 28
Regjistrimi i kontratës

Brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i kësaj kontrate, Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim duhet ta regjistrojë kontratën në Zyrën përkatëse të regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Neni 29

Kjo kontratë u hartua në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe, dhe pasi iu lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruajnë me vullnet të lirë e të plotë, dhe unë noterja e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

PALËT

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë


Përfaqësuar nga :

Z. ILIR BEJTJA

"HYDROPOWER" sh.p.k.

Përfaqësuar nga :

Z.



NOTERI



Kontratë "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 MW dhe veprave ndihmëse, në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria "HYDROPOWER" sh.p.k."